



Nr. 2100 prot.

Tiranë, më 01/12/2016

Drejtuar: Agjencisë së Prokurimit Publik

Tiranë

Lënda: Botim njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Rektorati i Universitetit të Arteve shpall konkursin për 1 (një) vënd të lirë pune për punonjës administrate në Rektorat si më poshtë:

- **Përgjegjës i Sektorit Mësimor**

1. Kandidati për pozicionin e lirë të punës duhet të plotësojë këto kritere:

- 1.1. Të ketë kryer arsimin e lartë (master shkencor);
- 1.2. Të njohë programet bazë kompjuterike;
- 1.3. Të ketë përvojë pune mbi 3 vjet;
- 1.4. Të ketë aftësi të mira komunikuese;
- 1.5. Të ketë dëshmi të një nga gjuhët ndërkombëtare (preferohet anglisht);
- 1.6. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prere nga Gjykata;

2. Dokumentacioni që duhet të plotësojë çdo dosje e kandidatit duhet të përmbajë materialet e mëposhtme:

- 2.1. Kërkesë nga kandidati ku të jetë përcaktuar specialiteti për të cilin konkuron;
- 2.2. Diplomë origjinale/ fotokopje e noterizuar që vërteton kryerjen e arsimit të lartë (për kandidatët që kanë mbaruar jashtë vendit njehsimi nga MAS);



- 2.3. Jetëshkrimi (CV), i shoqëruar me dokumentacionin përkatës që vërteton elementët e paraqitur në të;
- 2.4. Dokument (fotokopje e librezëz së punës), që vërteton përvojën në punë;
- 2.5. Letër reference/vlerësim pune nga punëdhënësi i fundit;
- 2.6. Dëshmi e gjuhës së huaj;
- 2.7. Kopje e letër njoftimit ose kartës së identitetit;
- 2.8. Çertifikatë familjare;
- 2.9. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
- 2.10. Dëshmi e gjendjes mjeksore.

Konkurrimi do të bazohet në plotësimin e kriterëve profesionale të Rektoratit dhe njohjen e ligjshmërisë në fuqi, kryesisht në Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", Kodin e Procedurave Administrative, Statutin e Universitetit të Arteve, i ndryshuar.

Dosjet e kandidatëve do të dorëzohen në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Universitetit të Arteve nga data **01. 12. 2016** deri më datë **15. 12. 2016** ora **14.00**.

Për datën e Konkursit kandidatët të informohen pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore çdo ditë nga ora **08.00** deri **14.00**.

Prof. Kastriot ÇAUSHI

REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE